

### Kalendar i konsultimit publik

**Titulli i Projekt-aktit :**

- Për dhënien e dakortësisë, për vijimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor publik të sipërfaqes pyjore prej 0.32(zero presje tridhjetë e dy) ha, e ndosur në ekonominë pyjore Bishnicë (Pjesa Ekonomike Uji I Ftohtë), për ndërtimin e hidrocentraleve “Zgallo1 & Zgallo 2 , nga shoqëria “Autovision AI” shpk ”
- Për dhënien e dakortësisë, për vijimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor publik të sipërfaqes pyjore prej 0.994( zero presje nëntëqind e nëntëdhjetë e katër)ha, e ndodhur në ekonominë pyjore Bishnicë (Pjesa Ekonomike Tallë), për ndërtim hidrocentrali “Shpella Poshtë II”, nga Shoqëria “Liria Energji” shpk”.

**Propozuesi :** *Bashkia Pogradec.*

Sqarime për projekt-aktin : Duke qënë se në të dy projekt vendimet kërkohet dhënia e dakortësisë për vijimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor publik të sipërfaqes prej 0.994 ha për ndërtimin e hidrocentraleve..Duke qënë se nëpërmjet këtyre projekt vendimeve kërkohet heqja nga fondi pyjor, Këshilli I Bashkisë Pogradec, në mbështetje të plotë të neneve 18, pika 1), 54 e Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen Vendore”, të ligjit nr.146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” si dhe në zbatim të Rregullores së Këshillit Pogradec për “Konsultimin Publikë” miratuar me VKB nr. 42, datë 05/03/2020, si dhe Rregullores për ankesat, kërkesat dhe peticionet iniciativat qytetare të Këshillit të Bashkisë Pogradec, miratuar me VKB nr. 67, datë 01/06/2020, Kryesia e Këshillit me vendim nr. 2, datë /07/2023, vendosi kalimin e kësaj iniciative për konsultim publik me të gjitha grupet e interesit

**Grupet që do të konsultohen:** *Banorët e Njesisë Administrative Velcan:*

Nr	Aktiviteti	Data	Vendi	Ora	Menyra	Forma
1.	Takim me banorët e Njesisë Administrative Velcan	04.08.2023	Qëndër të fshatit	10:00	Takim publik	Diskutime.

Kryetar i Komisionit: *Ilia Mani*

Sekretari i Këshillit: **Jona Bojko**

